# VITENE® ULTRA SC

| | |
|---|---|
| **Përbërja** | **Cimoxanil 21,56% (225 g/L)** |
| **Formulimi** | **Suspension konçentratë (SC)** |
| **Grupimi** | **FRAC 27** |
| **N. regjistrimit** | **494. Datë 02.10.2012** |
| **Konfeksioni** | **10ml, 20ml, 100ml, 1L** |

***Fungicid parandalues dhe kurues për kontrollin e vrugjeve***

## KARAKTERISTIKAT

**VITENE ULTRA SC** është fungicid lokosistemik trans-laminar, me efikasitet të lartë në kontrollin e vrugjeve të gjinive Phythophthora, Peronospora, Pseudoperonospora e Bremia në kultura të ndryshme bujqësore. Pas trajtimit shpërndahet në të gjitha pjesët e gjethes duke frenuar edhe infeksionin në pjesët e poshtëme të saj. Dallohet për efektin e shpejtë në bllokimin e mbirjes së sporeve dhe frenimin e rritjes së sporeve të porsambira, dhe micelit këpurdhorë.




| KULTURAT | DËMTUESI | MËNYRA PËRDORIMIT | KARENCA |
|---|---|---|---|
| VRESHTË (varietet tavoline dhe për verë) | Vrugu i hardhisë *(Plasmopara viticola)* | Përdorimi i vetëm: Bëhet ndërhyrje me 80-100 ml/hl (0.8-1 lit/ha), duke e futur në një strategji të përshtatshme mbrojtjeje. | 10 ditë |
| | Vrugu i hardhisë *(Plasmopara viticola)* | Trajtoni me dozë 50-60 ml/hl (500-600 ml/ha), në mënyrë të preferueshme në përzierje me produktet e kontaktit, të tillë si: ditiokarbamatët, produktet e bakrit, imidazolinoni ose mishelë komplekse me fosetil Alumini. Fillohet me trajtimet paraprake, në fillim të periudhës infektive dhe vazhdohet me ritme të diktuara nga shkalla e infeksionit të sëmundjes. Produkti është selektiv edhe gjatë lulëzimit. | |
| PATATE | Vrugu i patates *(Phytophthora infestans)* | Duke parë mënyrën e veçantë të veprimit të produktit citotropik, kurativ, është gjitmonë e këshillueshme të përdoret në përzierje me produktet e kontaktit, si ditiokarbamatët, të bakrit, me 90-135 ml/hl (500-530 ml/ha) | 7 ditë |
| SALLATË | Vrugu i sallatës *(Bremia lactuca)* | Duke parë mënyrën e vecantë të veprimit të produktit citotropik, kurativ, është gjitmonë e këshillueshme të përdoret në përzierje me produktet e kontaktit, si ditiokarbamatët, të bakrit, me 40-50 ml/hl (500-600 ml/ha). | 10 ditë |





## VËREJTJE PËR PËRDORIMIN:

Produkti është i pajtueshëm me të gjithë antiparazitarët me reaksion neutral ose acid. Këshillohet të përdoret së bashku me një produkt me reaksion alkalin dhe vaj mineral. Në rastin e përzierjes me formulime të tjerë, sugjerohet të sigurohemi paraprakisht në pajtueshmërinë fizike e kimike të secilës përzierje, duke përgatitur mënjanë një sasi të vogël para përdorimit.

| KULTURAT | DËMTUESI | MËNYRA PËRDORIMIT | KARENCA |
|---|---|---|---|
| SPINAQ | Vrugu i spinaqit *(Peronospora spinaciae)* | Trajtoni në përzierje me produktet e kontaktit, si ditiokarbamatët, të bakrit, me 40-50 ml/hl (500-600 ml/ha). | 10 ditë |
| | Vrugu i spinaqit *(Peronospora spinaciae)* | Në rastin e trajtimit vetëm me këtë produkt, dozat rezultojnë të jenë 700-800 ml/ha. Duhet pasur kujdes për të mos përqëndruar tretësirën mbuluese, sidomos në periudha të freskëta dhe/ose me ndryshime termike të forta dhe deri në 4-6 gjethe të vërteta të kulturës. Përgatitja e përzierjes së qullët: tretet doza e produktit në pak ujë, pastaj marrim një volum duke shtuar ujë të rrjedhshëm dhe duke e trazuar përzierjen në mënyrë të vazhdueshme. Për të garantuar një efikasitet më të madh të produktit, këshillohet të acidifikohet tretësira në vlera pH midis 5 dhe 6. | |
| DOMATE, DUHAN, ANGJINAR, QEPË, PJEPËR, BIZELE, KUNGULL, KASTRAVEC HUDHËR, PRESH, LULEDIELLI, SOJË DHE TRËNDAFIL | Vrugjet: Vrugu i domates *(Phytophthora infestans)*, Vrugu i kërcellit të domates *(Phytophthora parasitica)*, Vrugu i kastravecit *(Pseudoperonospora-cubensis)*, Vrugu i preshit *(Phytophothora porri)*, Vrugu i duhanit *(Peronospora tabacina)*, Vrugu i lulediellit *(Plasmopara helianthi)*, Vrugu i qepës *(Peronospora schleideni)* | Duke parë mënyrën e vecantë të veprimit të produktit citotropik, kurativ, është gjitmonë e këshillueshme të përdoret në përzierje me produktet e kontaktit, si ditiokarbamatët, të bakrit, me 40-50 ml/hl (500-600 ml/ha). | 10 ditë |